REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1935/1 Prot. Tiranë, më 06 . 11 .2026

VENDIM

Nr. 37, datë .06.11 .2026

PËR
MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË TEPRICËS SË FONDEVE TË LLOGARISË 604 TË AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT PËR VITIN 2026, SIPAS PROGRAMEVE DHE AKTIVITETEVE MBËSHTETËSE TË KËRKIMIT SHKENCOR

Në zbatim të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të ligjit nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", të VKM-së nr. 464, datë 31.07.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.08.2016, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", me kërkesë të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Bordi i Administrimit të AKKSHI-së, në mbledhjen e datës 06.11.2026,

VENDOSI:

1. Miratimin e përdorimit të tepricës së fondeve të llogarisë 604 të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit për vitin 2026, sipas programeve dhe aktiviteteve mbështetëse të kërkimit shkencor, në shumën totale prej **69.180.400 lekë** (gjashtëdhjetë e nëntë milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë, të krijuar nga fondet e pashfrytëzuara të programeve të kërkimit shkencor, që do të përdoren për financimin e Programit për mbështetjen e Studimeve të Doktoratës në vitin 2026.
Ndarja sipas tabelës së mëposhtme:

Programi/Aktiviteti	**Fondi i propozuar (lekë)**
Programi për Mbështetjen e Studimeve të Doktoratës në vitin 2026	61,291,194
Projektet Bilaterale me Turqinë – fond shtesë i parealizuar	+ 2,000,000
Programi READ – fond i parealizuar (pjesë e fondit të planifikuar)	+5,889,206
TOTALI (Doktoratura 2026)	**69,180,400 lekë**

Znj. Armela Baka, Kryetar _____
Z. Migel Hidi, Anëtar; _____
Z. Erjon Uka, Anëtar; _____
Znj. Mirela Cami, Anëtar; _____
Z. Laert Mezani, Anëtar; _____
Znj. Anisa Subashi, Anëtar; _____
Z. Vasil Tole, Anëtar; _____
Z. Fatbardh Sallaku, Anëtar; _____
Znj. Ines Muçostepa Anëtar; _____

2. Përcjelljen pranë Ministrisë së Arsimit të dokumentacionit përkatës, për vijimin e procedurave për përdorimin e tepricës së fondeve të llogarisë 604, sipas destinacioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjehere.

Znj. Armela Baka, Kryetar _____

Z. Migel Hidi, Anëtar; _____
Z. Erjon Uka, Anëtar; _____
Znj. Mirela Cami, Anëtar; _____

Z. Laert Mezani, Anëtar; _____
Znj. Anisa Subashi, Anëtar; _____
Z. Vasil Tole, Anëtar; _____
Z. Fatbardh Sallaku, Anëtar; _____
Znj. Ines Muçostepa Anëtar; _____